

Projekti Përkujtimor Grenfell



Propozime për Konsultim Formal

19 Maj 2026 – 11 Gusht 2026

Broshura e konsultimit

Përmbajtja

Parathënie –Jonathan Smith, Komisioneri i Shërbimit të Zjarrfikësve të Londrës	1
Rreth këtij dokumenti konsultimi	2
Sfondi	3
Kujt i drejtohet Projekti Përkujtimor Grenfell?	4
Propozimet origjinale të Projektit Përkujtimor Grenfell	5
Qasja jonë e rinovuar për zhvillimin e Projektit Përkujtimor Grenfell	5
Si po e zhvillojmë Projektin Përkujtimor Grenfell	6
Propozime për konsultim (në përgjigje të reagimeve fillestare)	7
Propozime për konsultim	8
Si reagimet nga angazhimi paraprak formësuan propozimet tona për konsultim	10
Si do të zbatohen projektet e propozuara	12
Plan-veprimi për propozimet përfundimtare dhe hapat e mëtejshëm	15
Çështje për t'u marrë në konsideratë	16
Shprehni mendimin tuaj	17

Parathënie

Faleminderit që gjetët kohë për të marrë pjesë në këtë konsultim publik mbi Projektin Përkujtimor Grenfell. Gatishmëria juaj për t'u angazhuar vlerësohet thellësisht.

Ky dokument paraqet propozimet tona për Projektin Përkujtimor Grenfell, të hartuar në bashkëpunim me palët paditëse në kuadër të Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve (ADR), duke përfshirë familjarë të afërt të personave që humbën jetën, të mbijetuar dhe banorë të zonës. Ka qenë një privilegj i i veçantë të dëgjojmë ata që ndanë përvojat, idetë dhe shpresat e tyre gjatë fazës së angazhimit paraprak të konsultimit vitin e kaluar. Kontributet e tyre kanë formësuar drejtpërdrejt rekomandimet e paraqitura në raportin e angazhimit paraprak dhe dëshiroj të falënderoj personalisht të gjithë pjesëmarrësit për çiltërsinë, bujarinë dhe besimin e tyre.

Zjarri në Kullën Grenfell më 14 qershor 2017 ishte zjarri më i rëndësishëm në Mbretërinë e Bashkuar që nga Lufta e Dytë Botërore. Pasojat e tij vazhdojnë të ndihen nga familjet dhe miqtë që humbën të dashurit, nga të mbijetuarit, banorët dhe komuniteti më i gjerë i Kensingtonit Verior dhe ngjarja mbetet thellësisht e gdhendur në ndërgjegjen tonë kombëtare. Ka shërbyer gjithashtu një katalizator për ndryshime të rëndësishme brenda Shërbimit të Zjarrfikësve të Londrës (LFB), duke na shtyrë të reflektojmë thellë, të reformojmë operacionet tona dhe të punojmë për të rindërtuar besimin me komunitetet e Grenfell.

Projekti Përkujtimor Grenfell buron nga një marrëveshje civile për zgjidhje e arritur në vitin 2023 midis paditësve të ADR dhe një numri organizatash të paditura, përfshirë LFB-në. Ai është pjesë përbërëse e një udhëtimi më të gjerë të Drejtësisë Restauruese. Ndërsa jemi të vetëdijshëm se rruga përpara është ende e gjatë, ky projekt synon të:

- ndihmojë në riparimin e marrëdhënieve ndërmjet LFB dhe komuniteteve të prekura nga zjarri në Kullën Grenfell
- të përkujtojë dhe të nderojë jetët e humbura
- krijojë një trashëgimi kuptimplote dhe të qëndrueshme për të përkujtuar zjarrin në Kullën Grenfell.

Ky konsultim fton familjet, miqtë dhe anëtarët e komunitetit të Grenfell të ndajnë pikëpamjet e tyre mbi propozimet tona për Projektin Përkujtimor Grenfell. Ka disa mënyra për pjesëmarrje, siç përcaktohet më poshtë në këtë dokument. Pikëpamjet tuaja kanë rëndësi dhe ne jemi të përkushtuar të dëgjojmë me kujdes dhe vëmendje gjithçka që ndani me ne përpara se të merren vendime. Jemi mirënjohës për kohën dhe zërin tuaj dhe presim me interes të dëgjojmë nga ju.

Jonathan Smith

Komisioneri i Shërbimit të Zjarrfikësve të Londrës



Drejtësia Restauruese është...

"Shqyrtimi, diskutimet dhe zbatimi i masave që palët përkatëse mund të kërkojnë të realizojnë, për të shënuar dhe përkujtuar zjarrin në Kullën Grenfell dhe ata që humbën jetën ose vuajtën si pasojë e tij."

Marrëveshja Civile
për Zgjidhje, 2023

Rreth këtij dokumenti konsultimi

Kjo broshurë ofron një përmbledhje të propozimeve tona të konsultimit mbi Projektin Përkujtimor Grenfell. Materiale të tjera mbështetëse janë gjithashtu të disponueshme në faqen tonë të dedikuar të internetit, duke përfshirë Raportin e pavarur të Angazhimit Paraprak të Konsultimit, Vlerësimin e Ndikimit në Barazi, Planin e Angazhimit dhe Komunikimit për Konsultimin, Pyetjet e Shpeshta (FAQs), dhe Materiale të përkthyer dhe versione të thjeshtuara për lexim.

Këto burime janë krijuar për t'ju ndihmuar të jepni përgjigje të informuara dhe kuptimplota.

Shoqërues i kësaj broshure është **Pyetësi i Konsultimit** të Projektit Përkujtimor Grenfell. Ju lutemi plotësojeni dhe na e ktheni pa pagesë duke përdorur adresën e mëposhtme:

Projekti Përkujtimor Grenfell
Shërbimi i Zjarrfikësve të Londrës
169 Union Street, Londër SE1 0LL

Zarfet FREEPOST (për postë e paguar nga marrësi / postë e parapaguar) janë të disponueshme sipas kërkesës.

Kjo broshurë është gjithashtu e disponueshme në faqen tonë të internetit, së bashku me formate alternative si përkthime në gjuhët e komunitetit dhe një version për Lexueshmëri të Lehtë. Nëse keni nevojë për këtë informacion në një format tjetër, ne do të bëjmë më të mirën për të plotësuar kërkesën tuaj.

Mund ta kërkonti duke na dërguar një email në kutinë tonë të dedikuar postare në adresën: **grenfell.engagement@london-fire.gov.uk**, ose duke na dërguar një mesazh me tekst në numrin **07385 382 580** duke na treguar çfarë nevojash keni.



Willie Thompson i mbijetuar nga zjarri në Kullën Grenfell dhe anëtar i Panelit Këshillimor të Pavarur të LFB-së.

Sfondi

Shërbimi i Zjarrfikësve të Londrës (LFB) ka një angazhim afatgjatë për të dëgjuar dhe për t'u angazhuar me ata, jeta e të cilëve u prek nga zjarri në Kullën Grenfell. Kjo përfshin familjarët e afërt të viktimave, të mbijetuarit, banorët dhe komunitetet më të gjera të Grenfell.

Projekti Përkujtimor Grenfell është një pjesë e kësaj pune të vazhdueshme dhe bën pjesë në angazhimet për Drejtësi Restauruese të bëra nga LFB, sipas Marrëveshjes Civile të Zgjidhjes të arritur me paditësit e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve (ADR) në mars 2023.

Si pjesë e kësaj marrëveshjeje, Komisioneri i Zjarrfikësve të Londrës (LFC) dedekoi **8.25 milionë £** për krijimin e Projektit Përkujtimor Grenfell. Qëllimi i projektit është të ndërtojë një trashëgimi kuptimplote dhe të qëndrueshme që nderon 72 jetët e humbura në zjarrin e Kullës Grenfell, duke mbështetur njëkohësisht shërimin dhe rimëkëmbjen kolektive brenda komunitetit.

Marrëveshja përcaktoi gjithashtu parime të qarta për mënyrën se si duhet të zhvillohet projekti. LFC u zotua të sigurojë që propozimet përfundimtare do të:

- mbrojnë dhe promovojnë interesat e paditësve të ADR-së, dhe të
- formësohen përmes konsultimit të plotë dhe kuptimplotë publik me komunitetet e Kensingtonit Verior dhe Grenfell.

LFB është e përkushtuar të konsultohet me komunitetet e Grenfell mbi detajet e Projektit të propozuar Përkujtimor Grenfell.

Krahas vlerave të vetë LFB-së, Projekti v Grenfell udhëhiqet nga parimet thelbësore të Drejtësisë Restauruese (RJ):

- Respekti për dinjitetin njerëzor;
- E vërteta përmes dialogut;
- Solidariteti dhe Përgjegjësia; dhe
- Drejtësia dhe Llogaridhënia.

Këto parime udhëheqin mënyrën se si po zhvillohet projekti.



Emma O'Connor e mbijetuar nga zjarri i Kullës Grenfell, ish-anëtare e Forumit të Komunitetit LFB dhe Krye-zjarrfikësi Charles Barton, roje e gjelbër, Stacioni i Zjarrfikësve të Kensingtonit të Veriut.

Kujt i drejtohet Projekti Përkujtimor Grenfell?

Zjarri në Kullën Grenfell pati një ndikim shkatërrues dhe afatgjatë - jo vetëm tek familjarët e afërt të 72 viktimave që humbën jetën, por edhe tek të mbijetuarit, fqinjët dhe komuniteti më i gjerë i Kensingtonit Verior. Pasojat e tij ndihen ende sot, përfshirë edhe nga persona që më pas janë zhvendosur nga zona ose kanë ardhur për të jetuar aty.

Kur flasim për 'Kensingtonin Verior dhe/ose komunitetet e Grenfell' - dhe për atë se kujt i shërben Projekti Përkujtimor Grenfell – kemi parasysh grupet e mëposhtme:

- Familjarët e afërt të viktimave/atyre që humbën jetën, duke përfshirë bashkëshortët ose partnerët, prindërit, fëmijët, vëllezërit e motrat, gjyshërit, nipërit dhe mbesat si dhe një të afërm të emëruar nga familja.
- Të mbijetuarit e zjarrit në Kullën Grenfell dhe personat që jetojnë brenda 500 metrave në kullë.
- Familjarë të tjerë të afërt të 72 viktimave/atyre që humbën jetën.
- Ish-banorët e Kullës Grenfell që jetonin në ndërtesë në kohën e zjarrit, por që më pas janë zhvendosur.
- Banorët e Kensingtonit Verior që jetojnë në lagjet e mëposhtme në momentin e zbatimit të projektit: Golborne, Colville, Notting Dale, St Helen's dhe Dalgarno.
- Paditësit e ADR-së, të cilët mund t'i përkasin një ose më shumë grupeve të renditura më sipër.

Ky projekt synon të njohë, mbështesë dhe nderojë ata, jeta e të cilëve u ndryshua nga tragjedia - qoftë përmes humbjes personale, mbijetesës, zhvendosjes apo lidhjes afatgjatë me zjarrin në Kullën Grenfell.



Intlak Alsaiegh (në cepin e djathtë me ngjyrë blu) Menaxhere e Projektit të Mirëqenies për të Moshuarit në Al Manaar - Qendra e Trashëgimisë Kulturore Myslimane, me gra vendase nga komuniteti.

Propozimet origjinale të Projektit Përkujtimor Grenfell

Vizioni fillestar për Projektin Përkujtimor Grenfell, i paraqitur nga disa prej paditësve të ADR-së nëpërmjet avokatëve të tyre, përfshinte tre projekte të ndërlidhura:

- **Një Arkiv Përkujtimor** – një arkiv dixhital që ruan të dhëna, dëshmi dhe materiale të tjera të lidhura me Grenfell-in, duke përfshirë dëshmi personale dhe të lokalizuara.
- **Një Ekspozitë Përkujtimore** – një hapësirë për të ndarë histori, përvoja dhe mësimet të lidhura me Grenfell-in.
- **Një Projekt Edukativ i Shtrirjes në Komunitet** – një program pesëvjeçar aktivitetesh të lidhura me arkivin dhe ekspozitën, përfshirë bursa për angazhim komunitar. Qëllimi i tij ishte të sigurohej që mësimet e nxjerra nga Grenfell, si dhe përvojat e personave të prekur, të integrohen në trajnim dhe në proceset e vazhdueshme të të nxëniet në të gjitha profesionet dhe industritë përkatëse.

Qasja jonë e rishikuar për zhvillimin e Projektit Përkujtimor Grenfell

Që nga arritja e marrëveshjes civile, kanë ndodhur disa ngjarje të rëndësishme - duke përfshirë Javën e Dëshmimeve për Grenfell, konsultimin e Këshillit të Qarkut Mbretëror të Kensington dhe Chelsea (RBKC) mbi iniciativat e tij për Drejtësi Restauruese, si dhe përfundimin e Fazës 2 të Hetimit për Kullën Grenfell. Së bashku, këto zhvillime e nxitën LFB-në të ndalet dhe të reflektojë nëse propozimet fillestare të marrëveshjes civile përmbushnin më së miri nevojat, prioritetet dhe shpresat e paditësve të ADR dhe komunitetit më të gjerë të Grenfell-it.

Në të njëjtën kohë, punë të tjera të lidhura kanë vazhduar, si planet e RBKC-së për një arkiv të Drejtësisë Sociale (përfshirë arkivin e Grenfell) dhe konsultimi i Komisionit për Memorialin e Kullës Grenfell mbi të ardhmen e vendndodhjes së Kullës Grenfell. Këto procese paralele kanë ndihmuar në orientimin e qasjes sonë dhe kanë theksuar nevojën për qartësi, koordinim dhe përdorim maksimal të fondeve për të shmangur dublimet.



Përpara financimit të programeve të reja, është e rëndësishme të identifikohen shërbimet ekzistuese dhe të bisedohet drejtpërdrejt me të rinjtë dhe organizatat lokale për të kuptuar çfarë mungon ose çfarë është e nënfinancuar.”

I/e mbijetuar dhe pjesëtar/e i/e rrethit të ngushtë familjar të viktimës



Nick Burton i mbijetuar i zjarrit në Kullën Grenfell, bashkëshort i një viktime dhe ish-anëtar i Forumit Komunitar të LFB-së.

Java e Dëshmimeve për Grenfell në janar 2024 ishte veçanërisht e rëndësishme. Gjatë katër ditëve, 47 familjarë të afërt të viktimave/ të ndjerëve, të mbijetuar dhe banorë ndanë dëshmi të fuqishme dhe thellësisht personale përmes fjalimeve, regjistrimeve, deklaratave të shkruara dhe veprave artistike.

Shumë prej tyre iu drejtuan organizatave që besojnë se janë përgjegjëse për tragjedinë. Fjalët e tyre ishin të sinqerta, emocionale dhe të drejtpërdrejta - dhe ato përcollën një mesazh të qartë: çdo vepër përkujtimore apo trashëgimie duhet të formësohet nga zërat e atyre që janë më të prekur. Më shumë informacion është i disponueshëm në: **www.testimonyweek.co.uk**

Si po e zhvillojmë Projektin Përkujtimor Grenfell

Për të bërë të mundur që Projekti Përkujtimor Grenfell të formësohet me kujdes dhe në mënyrë transparente, LFB po e zhvillon atë në tre faza:

Faza 1 Angazhimi paraprak i konsultimit

Faza 2 Konsultimi formal

Faza 3 Vendimarrja

Kjo qasje me faza është krijuar për të siguruar që projekti të zhvillohet përmes një dialogu të vërtetë me njerëzit të cilëve Projekti Përkujtimor Grenfell synon t'u shërbejë.



Propozime për konsultim (në përgjigje të reagimeve fillestare)

Nga shkurti deri në qershor 2025, LFB zhvilloi një periudhë angazhimi paraprak për konsultim. Gjatë kësaj kohe, u përqendruam në dëgjimin e paditësve të ADR - duke përfshirë familjarët e afërt të viktimave, të mbijetuarit dhe banorët e zonës - dhe porositëm një raport të pavarur për të pasqyruar atë që dëgjua. Ky raport është i disponueshëm në faqen tonë të internetit https://www.london-fire.gov.uk/media/xhdgedvm/summary_grenfell-memory-project-report-final-v05_albanian.pdf

Raporti paraqiti disa rekomandime lidhur me atë që duhet të përfshijë Projekti Përkujtimor Grenfell dhe mënyrën se si duhet të zbatohet. LFB u zotua t'i merrte seriozisht këto rekomandime - duke shqyrtuar secilën me kujdes dhe duke eksploruar se si ato mund të shndërroheshin në plane praktike dhe realiste.

Për ta bërë këtë, ne punuam në një mënyrë përsëritëse dhe reflektuese. Kjo do të thotë se idetë u zhvilluan gradualisht, hap pas hapi, ku çdo fazë u formësua nga ajo që mësuam në fazën pararendëse. Ndërsa propozimet evoluon, ne i rishikuam vazhdimisht në detaje për t'u siguruar që ishin të përballeshme, ligjrisht të qëndrueshme dhe realisht të zbatueshme. Ky proces vazhdoi deri në fazën e përgatitjes së dokumenteve të konsultimit formal dhe dhe dokumentacionin e qeverisjes.



Është thelbësore të mbahet mend se diskutimet rreth 8.25 milionë £ bazohen në realitetin tragjik të 72 jetëve të humbura.”

Letër e përbashkët nga familjarët e afërt të viktimave



Propozime për konsultim (në përgjigje të reagimeve fillestare)

Propozime për konsultim

Propozimet përqendrohen në **pesë iniciativa kryesore** që burojnë nga angazhimi paraprak për konsultim:

1 Një program pesëvjeçar grantesh i Projektit Përkujtimor Grenfell që mbulon tre drejtime të veçanta

A. Grante Përkujtimore Personale

Për familjarët e afërt të viktimave.

3 milionë £ gjatë 5 viteve

B. Grante për të rinjtë e prekur nga Grenfell

Të rinjtë mund të kualifikohen për të aplikuar nëse plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

a) kanë qenë në moshën 16–25 vjeç në kohën e zjarrit në Kullën Grenfell dhe kanë qenë pjesë e komunitetit të Kensingtonit Verior dhe/ose Grenfell në datën kur ra zjarri; OSE

b) janë të rinj deri në moshën 30 vjeç ose më të vegjël në kohën e zbatimit të projektit, me nevoja shtesë*, dhe janë pjesë e komunitetit të Kensingtonit Verior dhe/ose Grenfell.

1 milion £ për 5 vite

C. Grante për qëndrueshmërinë e komunitetit

Financim për grupe të prekura në mënyrë disproporcionale nga Grenfell dhe për aktivitete për përvjetorin e Grenfell të organizuara nga vetë komuniteti në nivel bazë.

1 milion £ për 5 vite

2 Një program pesëvjeçar me aktivitete rezidenciale dhe ditore

Për të mbështetur zhvillimin personal, vetëbesimin dhe aftësitë jetësore për të rinjtë e moshës 11-15 vjeç në periudhën e zbatimit të projektit dhe që jetojnë në Kensingtonin Verior dhe/ose janë pjesë e komuniteteve të Grenfell.

1.5 milion £ për 5 vite

*Nevojat shtesë nënkuptojnë të jetuarit me një aftësi të kufizuar, përballjen me sfida sociale ose personale, ose përjetimin e vështirësive.

“

Çdo familje e afërt... mund të vendosë vetë çfarë dëshiron të bëjë... Liria për të krijuar dhe përkujtuar realitetet tona, në vend që kjo të bëhet vazhdimisht përmes grupeve dhe iniciativave që janë marginalizuese.”

Familjar i afërt i viktimës/të ndjerit



Pjesë e 'Murit të së Vërtetës', krijuar nga komuniteti, i vendosur poshtë mbikalimit Westway.

Propozime për konsultim (në përgjigje të reagimeve fillestare)

- 3** **Një program pesëvjeçar për shtrirjen e aktiviteteve që mbështet njerëzit në komunitetet e Kensingtonit Verior dhe Grenfell të cilët janë të interesuar për karriera në sigurinë nga zjarri. Ky do të jetë një program i përvitshëm që promovon ndërgjegjësimin dhe mundësitë, përfshin punëtorë të targetuara dhe ofron financim për një kualifikim përkatës në sigurinë nga zjarri.**

Aktivitetet ndërgjegjëse dhe shtrirëse në komunitet synojnë të rrisin ndërgjegjësimin dhe të ofrojnë informacion, udhëzime dhe mbështetje për mundësitë e karrierës në sigurinë nga zjarri dhe kualifikimet e nevojshme për t'i ndjekur ato. Çdo vit, 12 persona do të kenë mundësi të marrin pjesë në një seri punëtorish (gjashtë) të drejtuara nga profesionistë me përvojë të sigurisë nga zjarri nga LFB.

Sesionet e punëtorëve do të ofrojnë këshilla praktike, njohuri për karrierën dhe mbështetje për të aplikuar për një Certifikatë të Sigurisë nga Zjarri të Nivelit 3, të ofruar nga institucione të jashtme trajnimi. Këto sesione do të ofrojnë gjithashtu mbështetje dhe këshilla për aplikimet në role të nivelit fillestar të sigurisë nga zjarri brenda LFB dhe organizatave të tjera.

Kostot e kësaj mbështetjeje dhe të kualifikimit për Certifikatën e Sigurisë nga Zjarri të Nivelit 3 do të mbulohen plotësisht nga Projekti Përkujtimor Grenfell.

Parashikohet që ky program do të përmirësojë mundësinë e anëtarëve të komuniteteve të Kensingtonit Verior dhe Grenfell, të prekur nga ngjarjet tragjike të zjarrit në Kullën Grenfell, për të ndjekur një kurs në sigurinë nga zjarri dhe për të aplikuar për karriera në këtë fushë brenda LFB dhe organizatave të tjera.

300,000 £ për 5 vite

- 4** **Reduktimi i tragjediave të ardhshme** Zhvillimi i burimeve edukative/të Zhvillimit Profesional të Vazhdueshëm (CPD) (me studime rasti të integruara nga Grenfell) si pjesë e ndikimit në ndryshimin e kulturës në sektorin e ndërtimit.

300,000 £

- 5** **Studim fizibiliteti (pa angazhim për zbatim)**

Për të vlerësuar realizueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e një qendre komunitare me fokus tek të rinjtë brenda zonës së mbulimit të Grenfell.

60,000 £



Që nga Grenfell, dhuna në zonë është rritur ndjeshëm, po ashtu edhe problemet e shëndetit mendor, veçanërisht tek të rinjtë. Edhe mundësitë për punësim kanë rënë ndjeshëm. ”

Banor që punon me të rinjtë e zonës

Së bashku, këto propozime synojnë të nderojnë 72 jetët e humbura, të ndihmojnë në mbajtjen gjallë të mësimet nga Grenfell dhe të mbështesin ata që ende janë të prekur, duke sjelle vlerë të shtuar - jo duke përsëritur - iniciativat ekzistuese të komunitetit.

Propozime për konsultim (në përgjigje të reagimeve fillestare)

Si reagimet nga angazhimi paraprak i konsultimit kanë formësuar propozimet tona për konsultim

Tema	Çfarë rekomandoi raporti	Çfarë propozohet	Çfarë synon të adresojë / arsyetimi	Fushat për reagime
Përkujtimi personal dhe përkujtimi i udhëhequr nga familja	Një skemë grantesh e dedikuar për të mbështetur projektet përkujtimore personale	Grante unike (jo të përsëritshme) për familjarët e afërt të viktimave, të mbështetura me këshillim nga ekipi i angazhimit Grenfell (3 milion £ për 5 vite)	Pranon faktin se përkujtimi është thellësisht personal dhe i larmishëm nga pikëpamja kulturore, dhe se familjarët e afërt mund të dëshirojnë të nderojnë të dashurit e tyre në mënyra të ndryshme	Mbështetje për propozimin: Kriteret e përzgjedhjes, nevojat për mbështetje të aplikantëve
Mbështetje për të rinjtë e prekur nga Grenfell (të moshës 16–25 vjeç në kohën e rënies së zjarrit në Kullën Grenfell) OSE deri në 30 vjeç me nevoja shtesë	Grante fleksibile për arsim, trajnim dhe zhvillim	Grante për aktivitete profesionale, trajnuese dhe përvoja praktike (1 milion £ për 5 vite)	Pranon ndikimin e zgjatur në kohë që Grenfell i shkaktoi këtij grupi gjatë një faze formuese të jetës	Mbështetje për propozimin: Kriteret e përzgjedhjes
Të rinjtë (11–15 vjeç) adoleshencë e hershme	Aktivitete që mbështesin zhvillimin personal, vetëbesimin dhe aftësitë jetësore	Një program aktiviteteesh rezidenciale dhe ditore të zbatuara përmes organizatave vullnetare lokale (1.5 milion £ për 5 vite)	Adreson boshllëqet në ofrimin e sigurt dhe të strukturuar në nivel lokal dhe mbështet zhvillimin personal, vetëbesimin dhe aftësitë jetësore të të rinjve	Mbështetje për propozimin: Qasje e bazuar në partneritet
Mësimi, parandalimi dhe ndryshimi	Përdorimi i përvojës së jetuar për të ndikuar praktikën, veçanërisht në mjedisin e ndërtuar	Integrimi i dëshmvive të Grenfell në formimin profesional; financim katalizator për të nxitur ndryshimin në sektor (300 mijë £)	I përgjigjet thirrjeve që Grenfell të çojë në ndryshime reale dhe të qëndrueshme dhe që përvoja të integrohet në trajnimet profesionale brenda sektorit të ndërtimit	Mbështetje për propozimin: Profesione të duhet të përfshihen

Propozime për konsultim (në përgjigje të reagimeve fillestare)

Tema	Çfarë rekomandoi raporti	Çfarë propozohet	Çfarë synon të adresojë / arsyetimi	Fushat për reagime
Aktivitete shtrirëse për të mundësuar qasje në trajnime dhe karriera në sigurinë nga zjarri	Mbështetje për rrugët drejt punësimit	Program vjetor për rritjen e ndërgjegjësimit për karrierat në sigurinë nga zjarri, punëtori të targetuara dhe financim për një kualifikim përkatës në sigurinë nga zjarri (300,000 £)	Rrit aftësinë e personave nga komunitete të traumatizuara dhe në disavantazh për të ndjekur një kurs sigurie nga zjarri dhe karriera në sigurinë nga zjarri	Aksesueshmëria
Iniciativa të udhëhequra nga komuniteti	Mbështetje për projekte nga baza e komunitetit, të ndjeshme dhe të përshtatura ndaj kontekstit kulturor	Përvjetori i Grenfell dhe grante të targetuara për komunitetin (1 milion £ për 5 vite)	Mbështet shërimin, kohezionin dhe grupet e prekura në mënyrë disproporcionale nga Grenfell	Mbështetje për propozimin
Qendër komunitare	Eksplorimi i një hapësire të përhershme komunitare	Studim i pavarur fizibiliteti (pa angazhim për zbatim) (60 mijë £)	Vlerëson nëse krijimi i një qendre të qëndrueshme është i zbatueshëm në praktikë, i kërkuar dhe i realizueshëm	Nëse qendra është një prioritet për komunitetin
Fondi rezervë	Fleksibilitet për prioritetet e ardhshme	1.09 milionë £ të rezervuara për t'iu përgjigjur rezultateve të konsultimit dhe për të kontribuar në qendrën komunitare, në varësi të përfundimeve të studimit të fizibilitetit	Siguron që çdo fond/shumë e papërdorur të jetë në përputhje me prioritetet e komunitetit	Cilat duhet të jenë prioritetet për fondet e papërdorura

Propozime për konsultim (në përgjigje të reagimeve fillestare)

Si pritet të zbatohen projektet e propozuara

Të gjitha pjesët e Projektit Përkujtimor Grenfell do të zhvillohen me përfshirjen e vazhdueshme të familjarëve të afërt të viktimave, të mbijetuarve dhe komunitetit më të gjerë. Kjo nënkupton që planet do të vazhdojnë të bashkë-hartohen dhe të formësohen nga njerëzit që ato synojnë të mbështesin, duke u siguruar që të pasqyrojnë nevojat, prioritetet dhe shpresat reale.

Programi pesëvjeçar i granteve

Një pjesë e rëndësishme e projektit është një program grantesh, të cilin ne synojmë ta zbatojmë përmes një kuadri unik të qartë me disa drejtime të ndryshme mbështetjeje. Kjo qasje lejon fleksibilitet, duke siguruar njëkohësisht që procesi të jetë i drejtë, transparent dhe i mirëmenaxhuar.

Për të siguruar një menaxhim të duhur të granteve, LFB po shqyrton mundësinë e bashkëpunimit me një organizatë të pavarur që zotëron ekspertizë të vërtetë dhe përvojë të konsoliduar në administrimin e programeve të granteve. Programi i granteve do të zhvillohej në dy faza:

- **Faza e projektimit** – Ne duam të punojmë ngushtë me njerëzit dhe grupet që këto grante synojnë të mbështesin, për të formësuar kriteret dhe procesin. Me këshillat e ekspertëve, kjo fazë do të përcaktonte marrëveshjen për çështje si kush mund të aplikojë, çfarë mund të financohet dhe si do të funksionojë procesi.
- **Faza e zbatimit** – Më pas mund të caktohet një partner i pavarur nga sektori vullnetar për të menaxhuar programin. Ata do të menaxhonin aplikimet, do të shpërndanin grantet dhe do të monitoronin mënyrën se si shpenzohen fondet, duke raportuar te LFB për të siguruar që gjithçka është bërë siç duhet.

“

Unë tashmë kam krijuar një projekt në kujtim të babait tim. Jam i/e rraskapitur, ndaj kam nevojë për financim për kostot bazë të funksionimit të projektit – kështu do t'i përdorja fondet e mia për Përkujtesë Personale.”

Familjar i afërt i të ndjerit/viktimës



Propozime për konsultim (në përgjigje të reagimeve fillestare)

Kjo qasje është krijuar për ta mbajtur komunitetin në qendër të vendimmarrjes, duke siguruar njëkohësisht që grantet të zbatohen në mënyrë profesionale, në mënyrë të drejtë dhe me llogaridhënie të fortë.

Program pesëvjeçar aktivitetesh për të rinjtë e zonës

Gjatë angazhimit paraprak të konsultimit, të rriturit dhe të rinjtë na thanë se dëshirojnë më shumë mundësi që të rinjtë të zhvillohen, të rrisin vetëbesimin dhe të mësojnë aftësi të rëndësishme jetësore jashtë shkollës. Ne kemi konstatuar gjithashtu se ekziston një mungesë e dukshme mbështetjeje për të rinjtë e moshës 11–15 vjeç, veçanërisht kur bëhet fjalë për programe të strukturuar afatgjata që ofrojnë udhëzim të vazhdueshëm.

Për t'iu përgjigjur kësaj, po propozojmë një program pesëvjeçar me udhëtime rezidenciale dhe aktivitete ditore për të rinjtë e moshës 11–15 vjeç nga komunitetet e Kensingtonit Verior dhe Grenfell. Qëllimi është të ndihmohen të rinjtë:

- **Të ndërtojnë vetëbesimin**
- **Të krijojnë miqësi të reja**
- **Të forcojnë aftësitë sociale**
- **Të zhvillojnë aftësi jetësore që do t'i mbështesin ata në moshë madhore**

Me shumë gjasa aktivitetet pritet të zhvillohen gjatë pushimeve shkollore dhe gjatë pesë viteve programi synon të ofrojë rreth 600 vende pjesëmarrjeje.

Programi do të hartohet së bashku me të rinjtë dhe do të zbatohet nga një grup organizatash lokale ekzistuese me përvojë dhe histori të fortë pune me të rinjtë. Puna e përbashkët në këtë mënyrë ndihmon të shmanget dublikimi dhe shfrytëzon maksimalisht aftësitë dhe njohuritë që tashmë ekzistojnë në komunitet.

Për të mbështetur mirëqenien e të rinjve, stafi që drejton aktivitetet do të marrë gjithashtu trajnim për shëndetin mendor, potencialisht në bashkëpunim me shërbimet e NHS-së. Kjo do të kontribuojë në zhvillimin e aftësive afatgjata brenda fuqisë punëtore lokale dhe mbështet rekomandimet e raportit të pavarur të angazhimit paraprak për forcimin e bashkëpunimit dhe kapaciteteve të komunitetit.

Program pesëvjeçar i shtrirjes së aktiviteteve që mbështet njerëzit në komunitetet e Kensingtonit të Veriut dhe Grenfell që janë të interesuar për karriera në sigurinë nga zjarri.

Ky do të jetë një program vjetor që promovon ndërgjegjësimin dhe mundësitë, përfshin punëtorë të targetuara dhe do të ofrojë financim për një kualifikim përkatës në sigurinë nga zjarri.

Aktivitetet e shtrirjes në komunitet synojnë të rrisin ndërgjegjësimin dhe të ofrojnë informacion, udhëzim dhe mbështetje për mundësitë e karrierës në sigurinë nga zjarri dhe kualifikimet e nevojshme për t'i ndjekur ato.



Përkujtesa nuk është vetëm të shohësh pas - është ajo që na ndihmon të ndërtojmë përpara.”

I mbijetuar i ri

Në përputhje me marrëveshjen civile, LFB do të mbulojë vetë të gjitha kostot e zbatimit. Kjo do të thotë se e gjithë shuma prej 8.25 milionë £ për Projektin Përkujtimor Grenfell do të shkojë drejtpërdrejt për komunitetin.

Propozime për konsultim (në përgjigje të reagimeve fillestare)

Çdo vit, 12 persona do të mund të marrin pjesë në një seri punëtorish (6) të drejtuara nga profesionistë me përvojë në sigurinë nga zjarri prej LFB. Sesionet e punëtorive do të përfshijnë këshilla praktike, njohuri mbi karrierën dhe mbështetje për aplikimin e një Certificate të Nivelit 3 në Sigurinë nga Zjarri, të ofruar nga trajnues të jashtëm. Këto sesione do të ofrojnë gjithashtu mbështetje dhe këshilla për aplikimet për pozicione të nivelit fillestar në sigurinë nga zjarri brenda LFB-së dhe organizatave të tjera.

Reduktimi i tragjediave të ardhshme

Sa i përket zhvillimit të burimeve edukative dhe të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional në profesionet e sektorit të ndërtimit, LFB do të punojë me familjet dhe anëtarët e komunitetit të interesuar, drejtues të industrisë dhe zhvilluesit përkatës të materialeve edukative/trajnuese për të prodhuar materiale të përshtatshme. Ne gjithashtu synojmë të shqyrtojmë mundësinë e përfshirjes së materialeve ekzistuese nga burime të tjera.

Propozim për studim fizibiliteti

Gjatë angazhimit paraprak të konsultimit, shumë persona thanë se dëshironin një qendër komunitare pranë Kullës Grenfell- një hapësirë praktike dhe mikpritëse ku njerëzit mund të lidhen, të shërojnë dhe të mbështesin të rinjtë. Duke qenë se Projekti Përkujtimor Grenfell nuk mund ta realizojë këtë projekt i vetëm, ne duhet të jemi të sigurt se është diçka që komuniteti e dëshiron vërtet, që është financiarisht i qëndrueshëm dhe ka partnerët e duhur për ta bërë funksional në praktikë. Kjo është arsyeja pse ne po propozojmë një studim të pavarur fizibiliteti. Ky studim do të ofronte një vlerësim të qartë dhe profesional të bazave:

- **A ekziston një vendndodhje e përshtatshme**
- **A ka kërkesë reale në komunitet?**
- **Sa do të kushtonte?**
- **Kush do ta menaxhonte atë në baza ditore?**
- **Kush do të duhet të përfshihet?**
- **Si mund të financohet dhe të mbahet në funksionim?**

Studime të tilla zakonisht janë të kushtueshme dhe jashtë mundësive të shumicës së grupeve komunitare. Duke e financuar atë përmes Projektit Përkujtimor Grenfell, komuniteti do të marrë këshilla ekspertësh, rekomandime praktike dhe një plan realist për atë që nevojitet për ta realizuar një qendër të tillë.

Edhe nëse studimi zbulon se qendra nuk është aktualisht e realizueshme, ai prapë do të ishte i dobishëm. Ai do t'u japë banorëve dhe grupeve komunitare informacionin e nevojshëm për të përmirësuar idenë, për të shqyrtuar alternativa, për të ndërtuar partneritete dhe për të zhvilluar projekte të tjera afatgjata të trashëgimisë për të ardhmen.



Projekti Përkujtimor Grenfell ka potencialin të luajë një rol të fuqishëm në parandalimin e tragjediave të ardhshme. Jo vetëm duke dokumentuar atë që ndodhi, por duke e bërë të pamundur injorimin e ndikimit njerëzor. Historitë, studimet e rasteve dhe mësimet nga Grenfell duhet të përdoren për të nxitur ndryshimin e kulturës dhe llogaridhënien në të gjithë mjedisin e ndërtuar.”


I/e mbijetuar dhe pjesëtar/e i/e rrethit të ngushtë familjar të viktimës



Ne besojmë se qendra komunitare është një ide e fuqishme. Ajo mund të ndihmojë në orientimin e të rinjve përfshirë nipin tonë... dhe fëmijëve tanë, larg sjelljes antisociale dhe drejt një mjedisi mbështetës intelektual dhe emocional. Një qendër e tillë do të shërbente si hapësirë pozitive, edukative dhe e sigurt si për të rinjtë ashtu edhe familjet – një trashëgimi jetike për të ardhmen.”

I/e mbijetuar dhe pjesëtar/e i/e rrethit të ngushtë familjar të viktimës

Plan veprimi për propozimet përfundimtare dhe hapat e ardhshëm



Çështje për t'u marrë në konsideratë

Mund të plotësoni një pyetësor online, i cili gjendet në faqen tonë të internetit

<https://www.london-fire.gov.uk/about-us/grenfell-tower-fire/grenfell-memory-project/>

Ndërsa shqyrtoni propozimet në këtë broshurë, mund t'ju ndihmojë të reflektoni mbi pikat e mëposhtme:

- A jeni dakord apo jo me propozimet për Projektin Përkujtimor Grenfell?
- A ju duken të përshtatshme shumat e propozuara të financimit? Na tregoni pse, dhe mos hezitoni të sugjeroni ndonjë alternativë.
- A ka diçka tjetër që mendoni se duhet të merret në konsideratë nga ne para se të merren vendimet përfundimtare?

Pikëpamjet tuaja do të formësojnë realisht atë që do të ndodhë më pas. Do të dëshironim shumë të dëgjonim mendimet tuaja - dhe ju lutemi inkurajoni familjen, fqinjët dhe miqtë tuaj në komunitetin Grenfell ose në gjithë Kensingtonin Verior që të ndajnë edhe ata mendimet e tyre.



Jepni mendimin tuaj

Ka shumë mënyra për të dhënë mendimin tuaj. Ne duam ta bëjmë sa më të lehtë që të jetë e mundur për ju të ndani pikëpamjet tuaja. Mund të përfshiheni në mënyrën që ju përshtatet më mirë:



- **Merrni pjesë në një nga aktivitetet tona:** Do të organizojmë një sërë aktivitetesh publike ku mund të mësoni më shumë dhe të ndani mendimet tuaja. Regjistrohuni në listën tonë të njoftimeve me email për të marrë të parët informacion mbi kohën dhe vendin e zhvillimit, ose të vizitoni faqen tonë të internetit. Skanoni Kodin QR më sipër.

- **Ejani lirshëm për një bisedë miqësore në aktivitetin tonë informues në komunitet:** Do të jemi të pranishëm në vende të njohura të zonës dhe hapësira komunitare. Kaloni për një bisedë rreth propozimeve. Lini të dhënat tuaja nëse dëshironi që ne t'ju dërgojmë orarin e plotë ose kontrolloni faqen tonë të internetit. Skanoni Kodin QR më sipër.

- **Plotësoni pyetësorin online:** Ndani pikëpamjet tuaja kudo që të jeni, në çdo kohë. Skanoni Kodin QR më sipër.

- **Na dërgoni email nëse preferoni:** Mund të na dërgoni thjesht reagimet/mendimet tuaja me email në **grenfell.engagement@london-fire.gov.uk**

- **Na ftoni të vijmë tek ju:** Nëse jeni pjesë e një grupi ose organizoni një aktivitet komunitar apo veror, jemi të gatshëm të vijmë dhe të diskutojmë propozimet me ju.

- **Na dërgoni mesazh në mediat sociale:**

Mund të na kontaktoni në

TikTok (@londonfirebrigade),

Instagram (@londonfirebrigade),

X (@LondonFire) dhe

Facebook (London Fire Brigade).

Na dërgoni një mesazh të drejtpërdrejtë dhe na ndiqni për përditësime.

- **Bëhuni Partner i Komunitetit:**

Organizoni një takim të vogël me ne - mbledhni 8-10 fqinjë, miq ose anëtarë të familjes nga Kensingtoni Verior dhe komuniteti i Grenfell. Këto takime të qeta dhe miqësore janë një mundësi për të ndarë përvoja, për të dëgjuar njëri-tjetrit dhe për të ndihmuar në formësimin e një projekti që synon të krijojë një trashëgimi kuptimplote. Duke bashkuar njerëzit, ju do të ndihmoni që zërat lokalë të dëgjohen, të vlerësohen dhe të jenë në qendër të konsultimit.*

*Numri i vendeve në dispozicion për partnerë është i kufizuar. Ju lutemi na kontaktoni shpejt.

Mund të kontaktoni gjithashtu ekipin e Projektit Përkujtimor Grenfell përmes:

- Telefonit, mesazhit ose WhatsApp: **07385 382 580**
- Email: **grenfell.engagement@london-fire.gov.uk**
- Postës: **Projekti Përkujtimor Grenfell, Shërbimi i Zjarrfikësve të Londrës, 169 Union Street, London SE1 0LL** Zarfet FREEPOST (me postë falas) janë të disponueshme sipas kërkesës.



Mësoni më shumë

Për detaje të plota rreth Projektit Përkujtimor Grenfell, skanoni kodin QR ose vizitoni:
london-fire.gov.uk/memory-project/



Merrni përditësime të rregullta

Regjistrohuni në listën tonë të email-eve për Projektin Përkujtimor Grenfell – **skanoni këtë kod QR**

Së bashku mund të ndërtojmë një trashëgimi me vlerë dhe domethënie.
Ju mund të kërkontë përkthimin e kësaj broshure përmes email-it:
grenfell.engagement@london-fire.gov.uk

Honorer la vie des êtres chers disparus et créer un héritage durable.

تکريم ذکری الأحباء وإنشاء تذكّار دائم.

স্বামী পরম্পরা গড়ার স্বার্থে হারানো প্রিয়জনদের প্রতি শ্রদ্ধাঞ্জলি অর্পণ।
ارج نهادن به زندگی عزیزان ازدست رفته، ایجاد میراثی ماندگار است.

Honorer la vie des êtres chers disparus et créer un héritage durable.

Insieme per onorare il ricordo delle persone care e lasciare un'eredità indelebile.

Honrar as vidas de entes queridos perdidos, criando um legado duradouro.

Odavanje pocasti izgubljenim životima voljenih, stvarajući trajno naslede.

Maamusida nolosha dadka ehelka ah ee dhintay, abuurista dhaxal waara.

ገህይወት እቶም ዝጠፍኡ እነፍቅሮም ሰባትም ክብር፣ነባሪህድሪ ምፍጣር።

Kaybettiğimiz sevdiklerimizin anısına kalıcı bir miras bırakabilmek için çalışıyoruz.

گزرے ہوئے پیاروں کی جانوں کے اعزاز میں ایک دائمی یادگار کی تخلیق۔

Để tỏ lòng trân trọng sinh mạng của những người thân yêu đã mất, tạo nên di sản lâu dài.



LONDON FIRE BRIGADE